

Përmbledhje

Norma e rritjes ekonomike për vitin 2014, sipas projeksioneve të BQK-së, parashihet të jetë 3.0 përqind. Kjo rritje pritet të mbështetet kryesisht nga rritja e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet pritet të kontribuojnë negativisht. Deri në shtator 2014, është shënuar rritje e kreditimit bankar, rritje e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë dhe rritje e remitencave. Megjithatë, gjatë së njëjtës periudhë është shënuar rritje e deficitit tregtar dhe rënie e investimeve publike dhe investimeve të huaja direkte. Si pasojë, parashikimi fillestar i rritjes ekonomike prej 3.7 përqind për vitin 2014 është reviduar në 3.0 përqind.

Ndërmjetësimi financiar gjatë TM3 2014 është karakterizuar me normë më të lartë të rritjes së kredive dhe depozitave. Kreditë kanë shënuar rritje vjetore prej 3.2 përqind ndërsa depozitat 7.4 përqind. Sektori bankar ka vazhduar të zvogëlojë normat e interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Mesatarja e normës së interesit në kredi gjatë muajit shtator 2014 ishte 10.8 përqind, ndërsa mesatarja e interesit në depozita ishte 1.0 përqind. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej 8.5 përqind në shtator 2014, e cila mbeti e pandryshuar krahasuar me shtator 2013. Sektori bankar vazhdon të ketë pozitë të kënaqshme edhe për sa i përket nivelit të kapitalizimit dhe të likuiditetit, të cilat janë përforcuar akoma më shumë në shtator 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet përmi-

rësimin të performancës së sektorit bankar në saje të rritjes së profitit si dhe rritjes së kapitalit nga aksionarët, ndërsa rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me kreditë ka ndikuar në rritjen e likuiditetit.

Sektori fiskal u karakterizua me rënie të konsiderueshme të shpenzimeve kapitale, të cilat ndikuan që shpenzimet e përgjithshme të shënojnë rënie, përkundër rritjes së shpenzimeve rrjedhëse. Në anën tjetër, të hyrat buxhetore regjistruan nivel të njëjtë krahasuar me vitin e kaluar.

Sektori i jashtëm deri në shtator 2014 është karakterizuar me rritje të deficitit tregtar prej 3.3 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së importit të mallrave prej 3.7 përqind. Eksporti i mallrave ka shënuar rritje prej 6.2 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së çmimit të metaleve në tregjet ndërkombëtare. Me rritje janë karakterizuar edhe eksporti i shërbimeve dhe remitencat, duke ndikuar kështu në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Investimet e huaja direkte kanë shënuar nivel dukshëm më të ulët krahasuar periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Inflacioni ka vazhduar të shënojë rënie. Deri në shtator 2014, norma mesatare e inflacionit ishte 0.5 përqind krahasuar me normën prej 2.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Niveli i inflacionit në Kosovë në masë të madhe reflekton lëvizjen e çmimeve të importit, që kryesisht reflektohet nëpërmjet çmimeve të produkteve ushqimore dhe çmimeve të naftës.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	04
Ekonomia e Kosovës	06
Sektori Real	06
Sektori Fiskal	09
Sistemi Financiar	10
Sektori Bankar	10
Fondet Pensionale	17
Institucionet Mikrofinanciare	18
Kompanitë e Sigurimit	19
Tregu i Bonove të Thesarit	20
Sektori i Jashtëm	21
GRAFIKËT DHE TABELAT	05
Figura 1. Norma e kreditimit ndër bankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së	05
Figura 2. Çmimi i naftës "brent crude"	05
Figura 3. Çmimi i arit për ounce	06
Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit	06
Figura 5. Norma e këmbimit e euros	06
Figura 6. Rritja reale e PBB-së	07
Figura 7. Norma e inflacionit sipas tremujorëve	07
Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve	08
Figura 9. Indekset e çmimit të konsumit, prodhimit dhe importit	08
Figura 10. Regjistri i bizneseve	08
Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja	09
Figura 12. Asetet e sistemit financiar në Kosovë	10
Figura 13. Asetet e bankave komerciale	10
Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave	11
Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive	11
Figura 16. Kreditë sipas sektorëve të veçantë ekonomik	12
Figura 17. Struktura e maturimit të kredive	12
Figura 18. Struktura e maturimit të kredive të reja	13
Figura 19. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale	13

Figura 20. Struktura e depozitave në bankat komerciale	13
Figura 21. Struktura e depozitave të afatizuara	14
Figura 22. Mesatarja e normave të interesit	14
Figura 23. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve	14
Figura 24. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare	15
Figura 25. Normat mesatare të interesit për depozita	15
Figura 26. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale	16
Figura 27. Treguesit e profitabilitetit	16
Figura 28. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë	17
Figura 29. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jopperformuese	17
Figura 30. Asetet e institucioneve mikrofinanciare	18
Figura 31. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit	18
Figura 32. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit	20
Figura 33. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit	20
Figura 34. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar	21
Figura 35. Remitencat	22
Figura 36. Struktura e investimeve direkte	22
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	24

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl. Swiss Franc: CHF</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>angl. Consumer Price Index: CPI</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro (<i>angl. Euro currency</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik (<i>angl. The Pound Sterling</i>)
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit (<i>angl. Index Price Index: IPI</i>)
NPL	Kreditë Jopërfomuese (<i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i>)
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i>)
USD	Dollari Amerikan (<i>angl. United States Dollar</i>)
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë shfaq shenja të një përmirësimi të lehtë në tremujorin e tretë të vitit 2014, duke tejkalaruar përkohësisht rrezikun e një rikthimi të recesionit. Në TM3 2014, rritja reale në eurozonë vlerësohet të ketë arritur në 0.2 përqind, nga 0.1 përqind sa ishte në tremujorin paraprak. Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, rritja ekonomike në eurozonë mbeti e pandryshuar në 0.8 përqind. Rritjen më të shpejtë në kuadër të eurozonës, në TM3 2014 kundrejt TM2 2014 e shënoi Greqia (0.7 përqind), gjë që shënon edhe daljen e këtij vendi nga recesioni pas gjashtë vitesh. Ekonomia e Gjermanisë, ndaj të cilës ekonomia e vendit është më e ekspozuar, u karakterizua me një kthesë të lehtë pozitive në aktivitetin ekonomik në tremujorin e tretë të vitit 2014, gjë që u përkthye në një rritje të lehtë të PBB-së tremujore në 0.1 përqind, nga rënia prej 0.1 përqind që shënoi në TM2 2014. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit paraprak, ekonomia e Gjermanisë shënoi një rritje vjetore prej 1.2 përqind në TM3 2014. Megjithatë, rritja ekonomike në eurozonë mbetet e dobët, përderisa rënia në indeksin që vlerëson sektorin e prodhimit¹ jep indikacione për një rritje ngjashëm të dobët edhe në tremujorin e fundit të vitit 2014.

Sipas Bankës Qendrore Evropiane, inflacioni në eurozonë në TM3 2014 zbriti në 0.4 përqind, nga 0.6 përqind në TM2 2014. Për vitin 2014, projeksionet për normën e inflacionit në Eurozonë janë reviduar në 0.5 përqind si pasojë e çmimeve më të ulëta gjatë gjysmës


së parë të vitit, por edhe i zhvillimeve më të ngadalshme në kërkesën e brendshme.

Ky nivel i inflacionit në Eurozonë vazhdon të jetë nën cakun prej 2 përqind, të përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), gjë që ka rritur domosdoshmërinë e masave për të rikthyer inflacionin më afër caktit. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, në javën e dytë të shtatorit 2014, BQE zvogëloi edhe më tutje normën bazë të rifinancimit, duke e zbritur në 0.05 përqind. Ndryshimi i normës bazë të rifinancimit është bërë me qëllim që të nxisë rritjen e kreditimit dhe, rrjedhimisht, të stimulojë aktivitetin ekonomik. Normat më të ulëta të interesit pritët të ndikojnë edhe në evitimin e vlerësimit të mundshëm të valutës euro kundrejt valutave tjera, duke ndikuar kështu në rritjen e konkurrueshmërisë së eksporteve të Eurozonës.

Zvogëlimi i normës bazë të rifinancimit nga BQE ka ndikuar në rënien e normave të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor. Në shtator 2014, normat 1 mujore të Euribor kanë rënë në mesatarisht 0.02 përqind nga 0.15 përqind në qershor 2014. Gjithashtu, normat mesatare për periudhën 12-mujore kanë shënuar rënie në mesatarisht 0.36 përqind në Shtator 2014, nga mesatarja prej 0.51 përqind në qershor 2014.

¹ Purchasing Managers Index – PMI.

Figura 1. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2014) dhe ECB (2014)


Performanca e aktivitetit ekonomik në Ballkanin Perëndimor në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014 përgjithësisht vlerësohet të jetë përkeqësuar, kryesisht si pasojë e rikuperimit të ngathët ekonomik në Bashkimin Evropian dhe zhvillimeve jo të favorshme në disa nga vendet e këtij rajoni.

Projeksionet për vitin 2014 sugjerojnë se Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina priten të karakterizohen me rënie ekonomike prej 0.5 përqind respektivisht rritje të dobët prej 0.7 përqind në vitin 2014. Shqipëria pritet të shënoj një rritje vjetore prej 2.1 përqind, përderisa Kosova dhe Mali i Zi priten të shënojnë një rritje vjetore prej 3.0 përkatësisht 2.3 përqind.

Ngjashëm me vendet e eurozonës, inflacioni në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2014 është karakterizuar me tendencë të dobët të rritjes. Në TM3 2014, vendet në këtë rajon kishin një normë mesatare të inflacionit prej 0.4 përqind, përderisa projeksionet e FMN-së sugjerojnë një normë mesatare të inflacionit për vitin 2014 prej 1.1 përqind në vitin 2014.

Çmimet e naftës (brent crude)² në shtator 2014 shënuan rënie prej 7.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Figura 2).

Figura 2. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD




Burimi: World Bank, EIA (2014), dhe kalkulime të BQK-së

Projeksionet e EIA (2014) sugjerojnë se rënia e çmimeve të naftës do të jetë rreth 4 përqind për vitin 2014, ndërsa për dy vitet e ardhshme këto çmime pritet të mbesin relativisht stabile.

Me rënie të çmimit në shtator të vitit 2014 u karakterizuan edhe metalet e arit (figura 3). Çmimi i arit gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me një rënie vjetore prej rreth 3.6 përqind. Zhvlerësimi i valutës së euros ndaj dollarit është reflektuar në rënie të kërkesës për ari gjatë kësaj periudhe, përderisa pritet sugjerojnë se çmimi i arit do të vazhdojë të shënoj rënie të lehtë edhe në pjesën e mbetur të vitit (FMN, 2014).

² 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.


Figura 3. Çmimi i arit, në USD për ounce



Burimi: World Bank (2014), Goldman Sachs, Merrill Lynch (2014*) dhe kalkulime të BQK-së

Mallrat ushqimore në nivel global gjatë TM3 2014 janë karakterizuar me rënie të çmimeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Figura 4). Rënia e çmimeve të drithërave gjatë TM3 2014 kundrejt TM3 2013 ishte rreth 3.7 përqind, përdërisa indeksi i përgjithshëm i mallrave ushqimore ishte më i ulët për rreth 12.6 përqind.

Figura 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAOUN (2014), Projektionet e FMN-së (2014) të kalkuluara nga BQK

Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore gjatë TM3 2014 kundrejt TM2 2014 është zhvlerësuar. Ndaj sterlinës britanike, euro ka shënuar rënie për 2.6 përqind; ndaj frankës zvicerane

ka shënuar rënie për 0.6 përqind; ndërsa ndaj dollarit amerikan për 3.4 përqind (Figura 5).

Figura 5. Norma e këmbimit e euros




Burimi: BQK (2014)

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Norma e rritjes ekonomike për vitin 2014, sipas projeksioneve të BQK-së, parashihet të jetë rreth 3.0 përqind (figura 6), që është më e ulët se sa parashikimi fillestar prej 3.7 përqind. Ky revidim është bërë kryesisht për shkak të nivelit më të ulët të investimeve publike në tremujorin e dytë dhe të tretë, rënies së theksuar të investimeve të huaja direkte në tremujorin e dytë por edhe rritjes së importeve në tremujorin e tretë. Rritja për vitin 2014 bazohet kryesisht në rritjen e konsumit ndërsa investimet dhe neto eksportet pritet të kontribuojnë negativisht.

Figura 6. Rritja reale e PBB-së, në përqindje




Burimi: ASK (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për vitin 2013 (2014)

Të dhënat deri në shtator 2014 paraqesin një rritje më të lartë të konsumit, i cili është ndikuar nga rritja e kredive konsumuese, rritja e pagave dhe mëditjeve të sektorit publik, pastaj subvencioneve dhe transfereve, etj. Gjithashtu, rritjen e konsumit e kanë përkrahur edhe remitencat, të cilat në gjysmën e parë të vitit 2014 kanë shënuar rritje prej 6.9 përqind. Në anën tjetër, investimet publike deri në shtator 2014 kanë shënuar rënie të konsiderueshme, ndërkohë që edhe investimet e huaja direkte (IHD) deri në qershor kanë shënuar rënie. Rënia e investimeve publike, e cila i atribuohet kryesisht zhvillimet politike lidhur me formimin e institucioneve, ka bërë që rritja reale e PBB-së të jetë më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Aktiviteti i sektorit privat është përkrahur nga kreditë e sistemit bankar të cilat kanë vazhduar të rriten në mënyrë të përsheptuar.

Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2014 është duke u karakterizuar me normë dukshëm më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Për dallim nga viti 2013, i cili kishte filluar me normë më të lartë të inflacionit dhe ishte

karakterizuar me rënie të vazhdueshme, viti 2014 ka filluar me normë shumë të ulët të inflacionit dhe është ngritur gradualisht. Norma mesatare vjetore e inflacionit në periudhën janar – shtator 2014 ishte 0.5 përqind krahasuar me mesataren prej 2.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërkohë që vetëm në shtator 2014 është shënuar norma vjetore e inflacionit prej 1.3 përqind (figura 7).


Figura 7. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2014)

Mesatarisht gjatë periudhës janar-shtator 2014, komponentët e CPI-së si pijet alkoolike dhe duhani shënuan rritje për 4.8 përqind, veshmbathja 3.2 përqind dhe rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse 3.2 përqind. Ndërsa, rënie e çmimeve kryesisht u evidentua tek shërbimet e transportit me 1.4 përqind, kryesisht për shkak të rënies së çmimit të derivateve të naftës. Përveç çmimeve të transportit, edhe ushqimi dhe pijet joalkoolike u karakterizuan me rënie prej 0.6 përqind (figura 8). Ushqimi i cili përbën rreth 37.8 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, paraqet kategorinë kryesore që është duke shkaktuar rënien e inflacionit.


Figura 8. Lëvizja e çmimeve sipas komponentëve, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2014)

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është mjaft e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet. Kjo tregohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me CPI-në (figura 9).

Figura 9. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2014)

Që nga viti i kaluar, indeksi i çmimeve të importit është duke shënuar rënie. Mesatarja e çmimeve të importit gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 ka shënuar rënie vjetore për 0.2 përqind (1.0 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2013). Në kuadër të çmimeve të importit, çmimet e produkteve bimore dhe këpucëve kanë shënuar rritjen më të lartë gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 me nga 23.0 përqind

secila ndërsa çmimet e tekstilit kanë shënuar rënie më të lartë prej 24.6 përqind.

Indeksi i çmimeve të prodhimit në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014 shënoi rënie mesatare vjetore prej 0.6 përqind ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kishte shënuar rritje prej 4.8 përqind. Kjo rënie e çmimeve të prodhimit më së shumti u nxit nga rënia e çmimeve të administruara siç janë: nxjerrja e qymyrit dhe linjtit të cilat shënuan rënie të çmimit prej 19.3 përqind, pasuar nga rënia e çmimeve të prodhimit të pajisjeve elektrike prej 13.9 përqind, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (7.9 përqind rënie).

Figura 10. Regjistrimi i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2014)

Regjistrimi i ndërmarrjeve deri në qershor 2014 u karakterizua me 5,311 ndërmarrje të reja të regjistruara, që është për 294 ndërmarrje më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa u mbyllën 881 biznese apo 119 biznese më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 10).

Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është pothuajse e njëjtë me vitin e kaluar ku dominojnë tregtia, industria përpunuese, hoteleria dhe

ndërtimtaria (figura 11). Rënia e numrit të bizneseve të regjistruara krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kryesisht është shënuar tek sektori i patundshmërisë dhe ai i ndërtimtarisë me 182 përkatësisht 75 ndërmarrje më pak, ndërsa hoteleria dhe ndërmarrjet me aktivitet financiar kanë shënuar rritje për 66 përkatësisht 9 ndërmarrje më shumë.

Figura 11. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore neto deri në shtator 2014 shënuan nivel të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën prej 964 milionë euro. Ky nivel i ngjashëm i të hyrave është arritur përkundër faktit se deri në shtator 2014 nuk janë arkëtuar të hyra në formë të dividendës nga ndërmarrjet publike, ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin realizuar 30.0 milionë euro të hyra nga dividenda. Nëse përjashtohen të hyrat nga dividenda e realizuar në vitin 2013, atëherë të hyrat buxhetore deri në shtator 2014 shënuan rritje prej 3.5 përqind. Shpenzimet buxhetore deri në shtator 2014 arritën vlerën prej 967.4 milionë euro që paraqet rënie vjetore prej 1.1 përqind. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe,

buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej vetëm 3.5 milionë euro krahasuar me deficitin prej 14.1 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ekzekutimi i shpenzimeve të planifikuara deri në shtator 2014 ishte pothuajse i njëjtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (60 përqind e planit vjetor). Pagat dhe mëditjet si dhe subvencionet dhe transferet shënuan nivel më të mirë të realizimit krahasuar me planin, ndërsa shpenzimet kapitale u realizuan vetëm në masën prej 41.0 përqind e planit deri në shtator 2014 krahasuar me shkallën prej 54.2 përqind të realizimit në shtator të vitit të kaluar. Në anën tjetër, realizimi i të hyrave buxhetore arriti nivelin prej 66 përqind e planit për vitin 2014, që është për 1.6 pikë përqindje më i ulët se sa në periudhën e njëjtë e vitit të paraprak.

Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, vërehet rritje e të hyrave të mbledhura në kufi të cilat shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind dhe arritën nivelin neto prej 632.1 milionë euro. Të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën neto prej 199.5 milionë euro që janë për 1.7 përqind më të ulëta se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat jo-tatimore arritën vlerën prej 36.2 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 8.5 përqind. Gjithashtu, të hyrat vetanake (niveli qendror dhe lokal) shënuan rritje për 6.8 përqind duke arritur vlerën prej 72.7 milionë euro.


Sa i përket shpenzimeve, deri në shtator 2014 të gjitha kategoritë shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, me përjashtim të shpenzimeve kapitale të cilat shënuan rënie.

Investimet kapitale, që deri në shtator 2014 përfaqësuan rreth 23.0 përqind të gjithsej shpenzimeve, shënuan vlerën prej 222.2 milionë euro që paraqet rënie prej 36.2 përqind. Zvogëlimi i investimeve kapitale i adresohet përfundimit të projektit të autostradës R-7, e cila në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë në implementim e sipër. Përveç përfundimit të projektit të autostradës R-7, vonesa në krijimin e institucioneve pas zgjedhjeve të 8 qershorit 2014 ndikoi në shtyrjen e realizimit të shumë projekteve. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje kanë shënuar rritje prej 28.9 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 357.8 milionë euro, që është kryesisht rezultat i vendimit të qeverisë për ngritjen e pagave. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime kanë shënuar rritje për 4.6 përqind dhe kanë shënuar vlerën prej 136.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë shënuar rritje për 10.6 përqind dhe kanë arritur vlerën prej 251.3 milionë euro.

Sistemi Financiar

Në shtator 2014, vlera e asetëve të sistemit financiar

Figura 12. Asetet e sistemit financiar të Kosovës, në përqindje (shtator 2014)



Burimi: BQK (2014)

të Kosovës arriti në 4.46 miliardë euro, duke shënuar

rritje vjetore prej 10.2 përqind. Kjo rritje gjatë nëntëmuorit të vitit 2014 i atribuohet kryesisht rritjes së asetëve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale, sektorë këta që dominojnë asetet e sistemit financiar. Sektori i sigurimeve, ai mikrofinanciar dhe i ndihmësve financiar pavarësisht zgjerimit të aktivitetit, kishin kontribut të vogël në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit. (figura 12).


Sektori Bankar

Deri në shtator 2014, në tregun bankar në Kosovë operuan 10 (dhjetë) banka komerciale, prej të cilave 8 (tetë) kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 90.5 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar.

Asetet

Deri në shtator 2014 bankat përshpejtuan ritmin e rritjes së aktivitetit të tyre, duke ndërprerë kështu trendin e ngadalësuar të rritjes së asetëve që kishte karakterizuar këtë sektor gjatë viteve të fundit. Vlera

Figura 13. Asetet e bankave komerciale, ndryshimet vjetore, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

e gjithsej asetëve në shtator 2014 arriti në 3.15 miliard euro, që përkon me një rritje vjetore prej 7.3 përqind (figura 13).


Rritja e aseteve të sektorit bankar gjatë nëntëmuajorit të vitit 2014 kryesisht i atribuohet rritjes së investimeve në letra me vlerë, pasuar nga bilanci me bankat komerciale dhe aktiviteti kreditues. Investimet në letrat me vlerë në shtator 2014 arritën në 410.0 milionë euro duke u karakterizuar me rritje vjetore prej 48.6 përqind.

Struktura e portfolios së investimeve në letra me vlerë vazhdon të dominohet nga fletëobligacionet e qeverive të huaja të cilat në shtator 2014 përbënin 59.7 përqind të gjithsej letrave me vlerë (rritje vjetore prej 45.3 përqind). Në shtator 2014 investimet në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës rritën pjesëmarrjen e tyre në 40.2 përqind të gjithsej letrave me vlerë (rritje vjetore prej 53.5 përqind) Bilanci me bankat komerciale, që kryesisht paraqet depozitat e mbajtura në bankat jashtë vendit, shënoi rritje vjetore prej 17.4 përqind në periudhën raportuese.

Kreditë

Aktiviteti kreditues gjatë nëntëmuajorit të vitit 2014 u

Figura 14. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

karakterizua me ritëm më të përshpejtuar të rritjes krahasuar me vitin paraprak. Gjithsej kreditë arritën

vlerën 1.85 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.2 përqind në shtator 2014, që është më e lartë krahasuar me rritjen prej 2.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 14).

Kreditë e reja të lëshuara gjatë periudhës janar-shtator 2014 shënuan rritje vjetore prej 36.6 përqind, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kreditë e reja kishin shënuar rënie vjetore prej 3.8 përqind.

Figura 15. Vlerat dhe ndryshimet vjetore të kredive, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive e kishin kreditë për ekonomitë familjare, të cilat shënuan rritje të përshpejtuar prej 9.5 përqind, (rritje prej 2.6 përqind në shtator 2013). Në të njëjtën periudhë, kreditë për ndërmarrje kishin kontribut më të vogël duke shënuar rritje vjetore më të ngadalshme prej 1.6 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.1 përqind në shtator 2013 (figura 15).

Përshpejtimi i trendit të rritjes së kredive për ekonomitë familjare, mes tjerash, mund t'i atribuohet rritjes së pagave për shërbyesit civil dhe lehtësimit deri në një masë të standardeve kreditore për ekonomitë familjare, faktorë që mund të kenë ndikuar

në rritjen e kërkesës dhe potencialit kredimarrës nga ky sektor. Ndërsa, ngadalësimi i rritjes së kredive për ndërmarrjet mund të ketë rezultuar nga oferta ende më e shtrënguar kredituese ndaj ndërmarrjeve më të mëdha.³

Sipas veprimtarive ekonomike, struktura e kredive të ndërmarrjeve vazhdon të dominohet nga kreditë e destinuar për tregti me pjesëmarrje prej 52.5 përqind, pasuar nga prodhimtaria me 11.9 përqind dhe ndërtimtaria me 8.9 përqind. Njëri ndër sektorët me qasjen më të ulët në gjithsej kreditë për ndërmarrjet vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, me pjesëmarrje prej 4.0 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (figura 16).

Figura 16. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (shtator 2014)




Burimi: BQK (2014)

Në shtator 2014, kreditë për prodhimtari u karakterizuan me rritje vjetore prej 13.5 përqind krahasuar me rënien prej 3.1 përqind shënuar në shtator 2013. Gjithashtu, kreditë për tregti u karakterizuan me rritje prej 3.2 përqind krahasuar me rritjen prej 1.6 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërkaq, kreditë për bujqësi shënuan rënie të theksuar prej 11.8 përqind (rritje 30.9

përqind në shtator 2013), pasuar nga kreditë për ndërtimtari të cilat u zvogëluan për 11.0 përqind (2.4 përqind rënie në shtator 2013)

Figura 17. Struktura e maturimit të kredive




Burimi: BQK (2014)

Sipas maturitetit, edhe gjatë nëntëmujorit të vitit 2014 struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë ‘mbi 1 deri në 5 vite’, edhe pse vërehet një trend i ngushtimit të lehtë të tyre gjatë viteve të fundit (figura 17). Ky zvogëlim në portfolion e kredive me maturim ‘nga 1 deri 5 vite’ është i shprehur si të kreditë e ndërmarrjeve ashtu edhe tek kreditë e ekonomive familjare. Krahasuar me vitin paraprak, në shtator 2014 vihet re një rritje e pjesëmarrjes së kredive me afat më të shkurtër maturimi ‘deri në 1 vit’ si dhe tek kreditë afatgjata ‘mbi 5 vite’.

Asetet e sektorit bankar kanë përshpejtuar ritmin e rritjes si rezultat i rritjes më të theksuar të investimeve në letra me vlerë, plasmaneve në bankat komerciale jashtë vendit dhe kredive të lëshuara në ekonominë vendore.

³ Bazuar në rezultatet e fundit të anketës për kreditimin bankar.

Figura 18. Struktura e maturimit të kredive të reja




Burimi: BQK (2014)

Depozitat

Gjithsej depozitat në sektorin bankar në shtator 2014 arritën vlerën 2.52 miliardë euro, rritje vjetore prej 7.4 përqind që është dukshëm më e lartë se dy vitet e kaluara (figura 19).

Figura 19. Ndryshimi vjetor i depozitave në bankat komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej depozitave në shtator 2014 vazhduan ta kenë depozitat e ekonomive familjare, të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.5 përqind (8.0 përqind në shtator 2013). Gjithashtu, depozitat e ndërmarrjeve, të cilat në dy vitet paraprake kishin shënuar rënie, në shtator 2014 shënuan rritje vjetore prej 8.2 përqind (-0.9

përqind në shtator 2013). Depozitat tjera (depozitat e jo-rezidentëve, organizatave jo-qeveritare etj.) shënuan rritje vjetore prej 3.0 përqind në shtator 2014, që përbën një rritje dukshëm më të vogël se rritja prej 15.1 përqind në shtator 2013.

Strukturën e depozitave në sektorin bankar vazhdojnë ta dominojnë depozitat e ekonomive familjare me pjesëmarrje prej 72.8 përqind në gjithsej depozitat, duke vazhduar kështu të jenë burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Kategoria e dytë për nga madhësia përbëhet nga depozitat e ndërmarrjeve që kanë një pjesëmarrje prej 22.1 përqind në gjithsej depozitat. Ndërsa, depozitat tjera në shtator 2014 kishin një pjesëmarrje prej 5.1 përqind në gjithsej depozitat e sektorit bankar (figura 20).

Figura 20. Struktura e depozitave në bankat komerciale




Burimi: BQK (2014)

Depozitat e transferueshme dhe të kursimeve rritën pjesëmarrjen e tyre në gjithsej depozitat, kurse depozitat e afatizuara zvogëluan pjesëmarrjen. Rënia e theksuar e normave të interesit në depozita gjatë vitit 2014 mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara. Kurse, sa i përket strukturës së depozitave të afatizuara, në

periudhën raportuese vihet re një rritje të pjesëmarrjes së depozitave me afat më të gjatë maturimi krahasuar me depozitat me afat më të shkurtër maturimi (figura 21).

Figura 21. Struktura e depozitave të afatizuara




Burimi: BQK (2014)

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita kanë vazhduar trendin rënës edhe shtator 2014.

Figura 22. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 10.8 përqind krahasuar me 12.2 përqind në shtator 2013.

Në depozita, norma e interesit u zvogëluar në 1.0 përqind në shtator 2014, nga 3.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vlen të theksohet se vërehet tendencë e rritjes së normave të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita në shtator 2014 krahasuar me qershor 2014 (figura 22).

Trendi i rënies së normave mesatare në kredi është shprehur si tek kreditë për ndërmarrje, ashtu edhe për kreditë për ekonomitë familjare. Sa i përket kredive për ndërmarrje, norma mesatare e interesit në shtator 2014 është zvogëluar në 10.7 përqind nga 12.5 përqind sa ishte në shtator 2013. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, rënien më të theksuar e shënuan normat mesatare të interesit në kreditë jo-investuese me maturitet 'deri në 1 vit', të cilat në shtator 2014 zbritën në 10.6 përqind. Me rënie të normës mesatare të interesit u karakterizuan edhe kreditë investuese 'deri në 1 vit', që arritën normën prej 11.8 përqind (figura 23).

Figura 23. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare në shtator 2014 është zvogëluar në 10.8 përqind, nga 11.6 përqind sa ishte në shtator 2013. Sipas qëllimit të përdorimit, kreditë konsumuese

shënuan rënie më të madhe duke zbritur në 10.9 përqind në shtator 2014 (12.2 në shtator 2013), përderisa norma mesatare e interesit në kredi hipotekare u zvogëluar në 9.3 përqind (10.1 përqind në shtator 2013) (figura 24).


Figura 24. Normat mesatare të interesit për kreditë e ekonomive familjare, në përqind



Burimi: BQK (2014)

Sa i përket normave të interesit në depozita, rënie u shënuar në të dy kategoritë kryesore të depozitave, gjegjësisht depozitat e ndërmarrjeve dhe të ekonomive familjare (figura 25).

Figura 25. Normat mesatare të interesit për depozita, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Dallimi ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita është zgjeruar në TM3 2014 si pasojë e rënies më të theksuar të normave të interesit në depozita gjatë kësaj periudhe kundrejt rënies së

normave të interesit në kredi. Në TM3 2014, ky dallim u rrit në 9.9 pikë përqindje, krahasuar me 8.8 pikë përqindje në TM3 2013 (figura 25).

Profitabiliteti dhe Performanca


Sektori bankar vazhdoi të përmirësojë performancën financiare duke gjeneruar nivelin më të lartë të profitit të arritur që prej fillimit të funksionimit të sektorit bankar. Deri në shtator 2014, profiti i sektorit bankar arriti vlerën prej 46.9 milionë euro, kundrejt profitit të arritur prej 22.4 milionë në shtator 2013. Rritja e profitit i atribuohet rënies së theksuar të shpenzimeve të sektorit bankar, krahas rënies së lehtë në të hyrat e këtij sektori.

Gjithsej shpenzimet e sektorit bankar deri në shtator 2014 u karakterizuan me rënie vjetore prej 17.1 përqind. Në zvogëlimin e gjithsej shpenzimeve kryesisht ndikuan shpenzimet e jo-interesit të cilat shënuan rënie vjetore prej 45.2 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, rënie më të madhe e shënuan shpenzimet për provizione, të cilat u reduktuan për 58.2 përqind në krahasim me vitin paraprak. Poashtu, shpenzimet e interesit deri në shtator 2014 shënuan rënie vjetore prej 24.7 përqind. Në kuadër të shpenzimeve të interesit, shpenzimet për interesin në depozita shënuan rënie vjetore prej 30.9 përqind. Ndërsa, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të gjithsej shpenzimeve, u karakterizuan me një rënie vjetore prej vetëm 0.4 përqind deri në shtator 2014, çka nënkupton që zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit bankar nuk është shumë i lidhur me përmirësimin e efikasitetit operacional.

Të hyrat e sektorit bankar deri në shtator 2014 u karakterizuan me rënie vjetore prej 2.0 përqind, që kryesisht rezultoi nga rënia e të hyrave nga interesi dhe atyre nga jo-interesi.

Deri në shtator 2014, të hyrat nga interesi përfaqësuan 80.5 përqind të gjithë të hyrave dhe shënuan rënie vjetore prej 0.9 përqind. Ky zvogëlim në arkëtimin e të hyrave kryesisht i atribuohet rënies së të hyrave nga interesi në kredi, që ndër tjerash u ndikuan nga normat më të ulëta të interesit krahasuar me vitet e kaluara. Të hyrat nga jo-interesi deri në shtator 2014 përfaqësuan 19.2 përqind të gjithë të hyrave dhe shënuan rënie vjetore prej 4.6 përqind. Kjo rënie ishte kryesisht pasojë e rënies së të hyrave nga të ardhurat tjera operative (që kanë një përfaqësim të vogël në gjithë të hyrat) dhe të ardhurave nga tarifat dhe komisionet për 25.1 përkatësisht 2.7 përqind.

Figura 26. Të hyrat dhe shpenzimet e bankave komerciale, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar u përmirësua dukshëm duke u zvogëluar në 74.4 përqind në shtator 2014, krahasuar 88.1 përqind sa ishte në shtator 2013 (figura 26). Gjithashtu, rritja e

theksuar e profitit deri në shtator 2014 bëri që Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) të përmirësohet në 2.0 përqind, nga 0.9 përqind sa ishte në 2013, përderisa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) u përmirësua në 21.5 përqind, nga 9.4 përqind në 2013 (figura 27).⁴

Figura 27. Treguesit e profitabilitetit




Për 2014 treguesit e profitabilitetit janë llogaritur duke u bazuar në performancën deri në Shtator 2014

Burimi: BQK (2014)

Rënia e theksuar e shpenzimeve krahas rënies së lehtë në të hyra ka ndikuar që profitit i sektorit bankar të regjistrojë rritje të theksuar, duke arritur kështu nivelin më të lartë që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar në Kosovë

⁴ ROAA dhe ROAE janë të analizuar me performancën e sektorit bankar deri në shtator 2014


Figura 28. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Në shtator 2014, pjesëmarrja e kredive jo performuese në gjithsej kreditë mbeti e pandryshuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 8.5 përqind (figura 28). Megjithatë, trendi i rritjes së kredive jo performuese është ngadalësuar krahasuar me periudhat paraprake. Në shtator 2014 norma vjetore e rritjes të vlerës së kredive jo performuese ishte 3.8 përqind, dukshëm më e ulët se sa 24.7 përqind sa ishte në shtator 2013 (figura 29).

Figura 29. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Kreditë jo performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Në shtator 2014, mbulueshmëria me provizione ishte 112.2 përqind (109.4 përqind në shtator 2013).

Po ashtu, sektori bankar ka përforcuar edhe më shumë nivelin e kapitalizimit, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) arriti në 18.1 përqind në shtator 2014 nga 16.4 përqind sa ishte në shtator 2013. Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar kryesisht i atribuohet përmirësimit të performancës së sektorit bankar në saje të rritjes së profitit si dhe rritjes së kapitalit nga aksionarët si rezultat i kërkesave të reja të BQK-së.

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Në shtator 2014, raporti i kredive ndaj depozitave arriti në 73.7 përqind nga 76.7 përqind në shtator 2013. Për më tepër, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 46.0 përqind në shtator 2014.⁵

Fondet pensionale

Asetet e sektorit pensional në shtator 2014 arritën vlerën prej 1.04 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 21.5 përqind. Struktura e aseteve të sektorit të pensioneve dominohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) i cili menaxhon 99.4 përqind të gjithsej aseteve, ndërsa pjesa e mbetur prej 0.6 përqind menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).

FKPK edhe gjatë nëntëmuajorit të vitit 2014 ka vazhduar të zgjerohet si rezultat i kthimit pozitiv në investime dhe arkëtimeve të reja të kontributeve pensionale. Gjithsej asetet e FKPK-së në shtator 2014 arritën vlerën prej 1.0 miliard euro. Në nëntë muajt e parë të vitit 2014, FKPK ka realizuar 46.4 milionë

⁵ Rregullorja përkatëse e BQK-së kërkon që raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të mos jetë më i ulët se 25 përqind.


euro kthim bruto nga investimet. Në ditën e fundit të shtatorit 2014, çmimi i aksionit arriti në 1.27 euro (1.17 euro në shtator 2013). Ndërsa, vlera e kontributeve të arkëtuara deri në shtator 2014 arriti në 95.2 milionë euro me rreth 469.5 mijë kontribuues.

Performancë pozitive është vërejtur edhe në aktivitetin e FSKP-së. Në shtator 2014, gjithsej asetet e FSKP-së kishin vlerën 5.7 milionë euro krahasuar me 5.2 milionë euro sa ishin në shtator 2013. Rritja kryesisht i atribuohet kthimit nga investimet, që deri në shtator 2014 arriti në 330.7 mijë euro. Në ditën e fundit të shtatorit 2014, çmimi i aksionit të FSKP-së arriti në 145.69 euro (134.71 euro në shtator 2013).⁶

Institucionet mikrofinanciare (IMF)

Gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar në shtator 2014 arritën vlerën 115.3 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 3.1 përqind krahasuar me rënie prej 7.5 përqind në shtator 2013 (figura 30).

Figura 30. Asetet e institucioneve mikrofinanciare, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Rritja e aseteve gjatë kësaj periudhe ishte kryesisht rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues dhe lizingut,

dy produkteve (shërbimeve) kryesore të IMF-ve. Në shtator 2014, gjithsej kreditë shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind, krahasuar me rënie prej 8.6 përqind në shtator 2013.

Në kuadër të gjithsej kredive, kreditë ndaj bizneseve shënuan rritje vjetore më të theksuar prej 7.0 përqind, ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje prej 1.7 përqind. Sipas maturimit, kreditë e IMF-ve vazhdojnë të kenë strukturën e njëjtë sikurse viteve të kaluara, dhe dominohen nga kreditë me afat të mesëm maturimi pasuar nga ato

Figura 31. Struktura e kredive të institucioneve mikrofinanciare sipas maturitetit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

me afat të shkurtër, kurse kreditë afatgjata vazhdojnë të kenë një përfaqësim të ulët. Kreditë me afat maturimi 'mbi 1 deri 5 vite' në shtator 2014 kishin një pjesëmarrje prej 85.0 përqind në gjithsej kreditë, pasuar nga ato me maturim 'deri 1 vit' me 14.6 përqind, dhe 'mbi 5 vite' me 0.4 përqind (figura 31).

Vlera e lizingjeve në shtator 2014 arriti vlerën prej 23.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.2 përqind (rritje prej 6.0 përqind në shtator 2013). Lizingjet për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 39.0 përqind në shtator 2014 (24.2 përqind në shtator 2013). Në anën tjetër, lizingjet për biznese u

⁶ Vlera bazë e aksionit të FSKP-së është 100 për dallim nga ajo e FKPK-së që është 1.

karakterizuan me rënie vjetore për 5.4 përqind, krahasuar me rritjen vjetore prej 1.5 përqind në shtator 2013.

Karakteristikë e sektorit mikrofinanciar vazhdojnë të jenë normat e larta të interesit në kredi. Mesatarja e normës efektive të interesit për kreditë e lëshuara nga institucionet mikrofinanciare në shtator 2014 ishte 23.4 përqind (24.0 përqind në shtator 2013). Për ndërmarrje, në shtator 2014 mesatarja e interesit në kredi ishte 24.6 përqind (23.7 përqind në shtator 2013) kurse për ekonomi familjare në shtator 2014 ishte 24.2 përqind (23.4 përqind në shtator 2013).

Në shtator 2014, niveli i kredive jo performuese në gjithsej kreditë qëndroi në 5.3 përqind, që paraqet një rënie të lehtë nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur ky raport ishte 5.7 përqind. Mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione ishte 111.4 përqind, që paraqet rritje nga niveli prej 109.7 përqind sa ishte në shtator 2013.

Deri në shtator 2014, sektori mikrofinanciar realizoi të hyra prej 14.2 milionë euro, që krahasuar me vitin e kaluar paraqet rënie prej 1.7 përqind (rënie prej 4.6 përqind deri në shtator 2013). Sidoqoftë, shpenzimet shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 15.4 përqind kryesisht si rezultat i reduktimit të shpenzimeve për personelin dhe zvogëlimit të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve deri në shtator 2014 u zvogëlua në 13.3 milionë euro, duke rezultuar kështu edhe në një profit prej 887.1 mijë euro kundrejt humbjeve të shënuara prej 1.3 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përmirësimi i performancës financiare

ndikoi në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 1.0 përqind (-0.3 përqind në vitin 2013) ndërsa ROAE u përmirësua në 3.9 përqind (-1.1 përqind në vitin 2013⁷).

Kompanitë e sigurimit

Gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në shtator 2014 shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind, duke arritur vlerën 137.5 milionë euro. Në kuadër të gjithsej asetëve, sigurimet jo-jetë përfshijnë 123.7 milionë euro, ndërsa sigurimet jetë 13.8 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe arriti në 62.6 milionë euro, që krahasuar me shtator 2013 paraqet një rritje prej 1.7 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë kanë gjeneruar 60.8 milionë euro, ndërsa ato të sigurimit jetë kanë gjeneruar 1.8 milionë euro. Vlera totale e dëmeve të paguara deri në shtator 2014 arriti në 24.3 milionë euro, prej të cilave 14.1 milionë janë dëme të paguara në kuadër të sigurimit të përgjegjësisë ndaj palës së tretë.

Deri në shtator 2014, sektori i sigurimeve regjistroi fitim në vlerë prej 968.8 mijë euro, që tregon për një përmirësim të theksuar krahasuar me vitin paraprak kur u shënuar humbje prej 183.4 mijë euro. Përmirësimi i performancës u evidentua edhe në sigurimet jetë edhe në ato jo-jetë. Deri në shtator 2014, sigurimi jo-jetë kishte fitime prej 351.5 mijë euro krahasuar me humbjet prej 540.5 mijë euro gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Sigurimi jetë u

⁷ ROAA dhe ROAE për vitin 2014 janë të analizuara me performancën e sektorit deri në shtator 2014.

karakterizua me rritje të mëtutjeshme të profitit në 617.3 mijë euro nga 357.1 mijë euro fitim deri në shtator 2013.

Rritja e profitit është evidentuar edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE). ROAA u përmirësua në 1.0 përqind (-0.3 përqind në vitin 2013) kurse ROAE u përmirësua në 2.7 përqind (-0.7 në vitin 2013⁸). përqind në 2013.

Sektori pensional vazhdoi të shënojë performancë të mirë financiare. Poashtu, rritje e aktivitetit dhe përmirësim i performancës u evidentua edhe tek sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar që kishin rritje të nivelit të arkëtimit të primeve përkatësisht dhënies së kredive.


Tregu i Bonove të Thesarit

Gjatë periudhës janar-shtator 2014, qeveria e Kosovës ka plotësuar nevojat për financim të aktiviteteve të saj duke zgjeruar vëllimin e emetimit të letrave me vlerë në 302.2 milionë euro (238.0 milionë në janar-shtator 2013).

Deri në shtator 2014, kalendari i publikuar për letra me vlerë ka pasur gjithsej 16 ankande. Prej tyre, 3 me afat maturimi 91 ditë, 6 me afat maturimi 182 ditë, 4 me afat maturimi 364 ditë, si dhe 3 ankande me afat maturimi dy vjeçar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kemi një zhvendosje të emetimit të

letrave me vlerë afatshkurtra në drejtim të atyre afatgjata (figura 32).


Figura 32. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Shuma e ofertuar nga pjesëmarrësit deri në shtator 2014 ishte 1.4 herë më e lartë se ajo e kërkuar nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Tejkalimi i vazhdueshëm i ofertave nga akterët primar kundrejt kërkesave të Qeverisë së Kosovës ka ndikuar në uljen e normave të interesit në letrat me vlerë për të gjitha kategoritë e maturimit.

Figura 33. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Kjo rënie ishte më e theksuar në fletëobligacionet qeveritare me maturim 1 vjeçar, që u ndikua edhe nga kërkesa më lartë e tyre deri në shtator 2014. Normat më të larta të interesit u hasën tek fletëobligacionet


⁸ ROAA dhe ROAE janë të analizuara me performancën e sektorit deri në shtator 2014

qeveritare me afat maturimi dy vjeçar (2.7 përqind), pasuar nga ato me maturim një vjeçar (1.5 përqind). Ndërsa, fletëobligacionet qeveritare me maturim 182 ditë dhe ato me maturim prej 91 ditë kishin norma të interesit prej 1.2 përkatësisht 0.5 përqind (figura 33).

Sektori i Jashtëm

Pozicioni i bilancit të pagesave në Kosovë është përkeqësuar në TM2 2014 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 162.8 milionë euro në TM2 2014, krahasuar me 114.3 milionë euro sa ishte në TM2 2013. Ky përkeqësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse kryesisht i atribuohet rritjes së deficitit në mallra për 4.2 përqind, përderisa bilanci i llogarisë së tregtisë në shërbime u zvogëlua për 4.0 përqind. Gjithashtu, në TM2 2014 kundrejt TM2 2013, llogaria e të ardhurave parësore dhe dytësore u karakterizuan me zvogëlim të bilancit pozitiv (3.4 përkatësisht 5.7 përqind).

Figura 34. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar, në milionë euro



Burimi: ASK (2014)

Deficiti i llogarisë së mallrave arriti vlerën prej 1.6 miliard euro deri në shtator 2014, që paraqet një rritje prej 3.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të

vitit paraprak (figura 34). Gjithsej eksportet në shtator të vitit 2014 arritën vlerën 237.7 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.2 përqind. Rritja e eksporteve gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së vlerës së eksporteve të metaleve bazë, si kategori me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të vendit, rritjes së eksporteve të produkteve minerale dhe eksporteve të produkteve bujqësore.


Vlera e gjithsej importeve në Kosovë, në shtator 2014 2014, arriti në 1.9 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.7 përqind (rënie vjetore prej 3.1 përqind në shtator 2013). Në kuadër të gjithsej importeve, me rritje u karakterizuan kategoria e makinerive dhe pajisjeve elektrike, produkteve kimikale, produkteve të plastikës dhe importet e paisjeve të transportit. Si rezultat i rritjes së vlerës së eksporteve deri në shtator 2014, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte u rrit në 12.7 përqind, nga 12.4 përqind sa ishte në shtator 2013.

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punonjësve, gjegjësisht të hyrat nga të ardhurat e punonjësve Kosovar jashtë vendit. Kjo kategori e të hyrave u karakterizua me zvogëlim në 98.9 milionë euro në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014, nga 110.0 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Remitencat, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, vazhdojnë të kontribuojnë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në TM2 2014, remitencat arritën vlerën prej 160.3 milionë euro,

duke shënuar rritje vjetore prej 10.9 përqind (figura 35). Vlera e gjithsej remitencave të pranuar në vend në gjashtë muajt e parë të vitit 2014 arriti në 291.3 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 6.9 përqind.


Figura 35. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Komponentë tjetër e rëndësishme në kuadër të bilancit të pagesave është edhe kategoria e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Bilanci i IHD-ve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 ishte 37.5 milionë euro, që paraqet një rënie të konsiderueshme krahasuar me vlerën prej 141.0 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie e IHD-ve mund t'i atribuohet kryesisht shitjes së aksioneve të disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë tek rezidentët kosovar, si dhe shpërndarjes së superdividendës⁹ së disa prej kompanive të huaja që operojnë në Kosovë (figura 36).

Figura 36. Struktur e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

⁹ Me superdividendë nënkuptohet dividendë e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë për periudhën përkatëse. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.

Citimi i sygjeruar i këtij publikimi:

BQK (2014): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 8 TM3 2014, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2014):

- a) Buletini Mujo Statistikor: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,129>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,163>

ASK (2014):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit, qasur në shtator 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit, qasur në shtator 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit, qasur në shtator 2014: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike, qasur në shtator 2014: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme, qasur në shtator 2014: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2014): Metal Prices database, qasur në shtator 2014.

FAOUN (2014): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: qasur në shtator 2014: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2014): Euribor Historical Rates, qasur në shtator 2014:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2014): World Economic Outlook: qasur në shtator 2014:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2013/02/weodata/index.aspx>

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2014/update/01/pdf/0114.pdf>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2013	Shtator 2014
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	2.2%	0.5%
Çmimet (fondi i periudhës)	0.2%	1.3%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	964.1	963.8
Shpenzimet (në milionë euro)	978.2	967.4
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-14.1	-3.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	4,045.6	4,457.0
prej të cilave: Bankat	2,935.4	3,149.5
Kredi	1,798.0	1,855.0
Depozita	2,344.7	2,518.0
Norma e interesit në kredi	12.2	10.8
Norma e interesit në depozita	3.4	1.0
Hendeku i normës së interesit	8.8	9.8
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	Qershor 2013	Qershor 2014
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-130.8	-199.0
prej të cilave: remitencat	272.4	291.3
Llogaria financiare	128.1	86.2
Investimet e huaj direkte në Kosovë	149.1	38.9
Investimet portfolio, net	-135.2	-53.4
Investimet tjera, net	130.5	74.2
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	276.2	327.8
Asetet	3,846.9	4,115.2
Detyrimet	3,570.7	3,787.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	1,541.0	1,646.2
Borxhi i jashtëm privat	1,146.1	1,264.4
Borxhi i jashtëm publik	394.8	381.8

Burimi:

1/ ASK (2014).

2/ MF (2014).

3/ BQK (2014).

